



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVO / REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA RAHOVEC / OPŠTINA ORAHOVAC / MUNICIPALITY RAHOVEC
KABINETI I KRYETARIT TË KOMUNËS / KABINET PRESEDIKA OPŠTINE / MUNICIPAL MAYOR CABINET

Njësia Nr./Br./No 02 (Kabineti i Kryetarit të Komunës)
Nr./Br./No 7734 Nr. i faq./Br.str./No.pg 76
Data/Datum/Date 5 / 8 / 26
RAHOVEC / ORAHOVAC

Vendi: QKMF – “Fahredin Hoti” – Rahovec, për buxhetin e vitit 2027.

Data: 29.07.2026, me fillim në orën 13:45.


Të pranishëm: Drejtori për Buxhet dhe Financa, Drejtori i Shëndetësisë, Afrim Oruqi, u.d i QKMF-së, Elbunit Kryeziu, zyrtarët komunalë dhe anëtarët e grupit punues për buxhet.

Afrim Limani: Të nderuar punëtorë të QKMF-së dhe ju pjesëmarrës. Më lejoni që në cilësinë e drejtorit për Buxhet dhe Financa t’ju shpjegojë buxhetin komunal për vitin 2027. Sipas Qarkores së Parë Buxhetore, që është dokument i rëndësishëm financiar i përcaktuar me Ligjin e Financave Publike dhe Përgjegjësisë dhe e përcakton hisen buxhetore për çdo komunë të Republikës së Kosovës. Sipas këtij dokumenti të rëndësishëm, buxheti i komunës së Rahovecit për vitin 2027 është 21.704.000€ dhe ndahet sipas programeve. Në administratë: 9.946.000 dhe kur e bëjmë një krahasim me vitin aktual, kemi rritje të buxhetit prej 778.000€. Në arsim: 634.305 dhe kur bëjmë krahasim me vitin 2026, kemi një zvogëlim prej 660.000. Në shëndetësi: 2.323.000 dhe kur bëjmë krahasim me vitin aktual, kemi një rënie prej 36.000. E falënderoj ekipin tim të financave, që brenda një afati shumë të shkurtër kemi bërë një punë shumë intensive. Në kategori ekonomike, përafërsisht buxheti duhet të jetë kështu: Pozicioni i pagave: 12.919.000€, mallra dhe shërbime 2.821.000, shpenzime komunal 440.00, subvencione 1.000.000 dhe investime kapitale 4.523.000, 374.000 euro më pak në vitin 2027 se sa në vitin 2026. Të nderuar pjesëmarrës, si rezultat i kontratës kolektive jemi në një krizë financiare, krejt kjo si pasojë e kontratës kolektive, e cila deri më tani i ka tërhequr 3.5 milionë. Buxheti i arsimit gjithashtu ka ndikuar që ulje të buxhetit, sepse mungesa e nxënësve llogaritet sipas formulës. Drejtpërdrejt në zvogëlimin e buxhetit është edhe numri më i vogël i popullsisë, pra jemi 14.000 banorë më pak se sa në regjistrimin e parafundit. Ju ftoj t’i paraqitni pyetjet dhe kërkesat e juaja rreth këtij dëgjimi publik.

Emrat	Kërkesat dhe idetë e punëtorëve shëndetësorë
Elbunit Kryeziu	Nevoja e madhe për një aparat të ri biokimik – për analiza biokimike. Kemi nevojë për uniforma të reja, gjithashtu kemi nevojë për inventore për laborator, si dhe stafi i QKMF-së të trajnohet për ultrazë.
Nazif Durkuti	Për vitin 2027, të rritet fondi për barna esenciale.
Etnik Popaj	Kërkesë për furnizim me material të nevojshëm për zyret tona.

Afrim Oruqi: E di që keni edhe kërkesa rreth atyre mëditjeve në vlerë prej 150€ për mjekë, por ju lus me mirëkuptim që të prisni edhe pak, sepse jemi në rrugë të mbarë dhe sipas ligjit do t'ju përfundojmë të gjitha obligimet e mbetura.

Afrim Limani: Ju falënderoj të gjithëve për pyetjet dhe kërkesat tuaja. Të gjitha kërkesat janë të shkruara dhe të njëjtat do të shqyrtohen, gjithnjë duke u bazuar në kapacitetet buxhetore të komunës për vitin 2027. Nëse edhe dikush tjetër nuk ka pyetje, atëherë ju falënderoj edhe një herë.

 **Procesmbajtësi:**

Albion Krasniqi